VENDIM
Nr.888, datë 3.11.2010

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, TË PËRZGJEDHUR NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pikat 1 e 3, e 18 të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, të përzgjedhur nga sektori ekonomik privat, si më poshtë vijon:

a) Z.Seyhan Pencapligil, Drejtor Ekzekutiv i Bankës Kombëtare Tregtare dhe anëtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave;

b) Z.Edmond Leka, president i Union Banks dhe anëtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave;

c) Z.Gjergj Gjika, Kryetar i Dhomës së Fasonistëve të Shqipërisë dhe anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit;

ç) Z.Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i Kompanisë "Sigal" dhe kryetar i Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë.

2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha